

VENDIM
Nr.179, datë 2.2.2011

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.478, DATË 18.7.2007 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË NËPUNËSVE TË DISA INSTITUCIONEVE, NË VARËSI TË MINISTRAVE TË LINJËS”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.478, datë 18.7.2007 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) në fund të shkronjës “a” të pikës 1, shfuqizohet emërtesa “Agjencia Shqiptare e Nxitjes së Biznesit dhe Investimeve” dhe shtohen emërtesat “Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve” e “Agjencia Kombëtare e Provimeve”.

b) Në fund të shkronjës “b” të pikës 1, shfuqizohen emërtesat “Agjencia Qendrore e Vlerësimit të Arritjeve të Nxënësve” dhe “Agjencia Kombëtare e Pranimeve në institucionet e arsimit të lartë” dhe shtohen emërtesat “Organi Kombëtar i Investigimit të Aksidenteve/Incidenteve Ajrore në Aviacionin Civil; “Teatri Kombëtar i Komedisë”; “Komisioni Shtetëror i Ndihmës Juridike” dhe “Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara”.

c) Pas pikës 2/7 shtohet pika 2/8, me këtë përmbajtje:

“2/8. Struktura dhe nivelet e pagave të nëpunësve në pozicionet “specialist” deri në “Titullar i institucionit” në Agjencinë Kombëtare të Provimeve, të jetë sipas lidhjes nr.1/8, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.”.

ç) Në kategorinë III-a të lidhjes nr.2, që përmendet në pikën 3, shtohen emërtesat “Administrator në Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara” dhe “Inspektor në Organin Kombëtar të Investigimit të Aksidenteve/Incidenteve Ajrore në Aviacionin Civil”.

d) Titulli i pikës II të lidhjes nr.2/1-B, të përmendur në pikën 3/1, ndryshohet si më poshtë vijon:

“II. Për Teatrin Kombëtar të Komedisë, Drejtorinë Artistike të Ansamblit të Këngëve dhe Valleve Popullore, të Teatrit Kombëtar të Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor dhe në Drejtorinë e Teatrit të Fëmijëve në Qendrën Kombëtare të Kulturës për Fëmijë.”.

dh) në fund të pikës 12 shtohen paragrafët, si më poshtë vijon:

“Titullari dhe administratorët në Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara përfitojnë një shtesë për kushte pune, në masën 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë në muaj, mbi pagën mujore të kategorisë përkatëse.

Anëtarët me kohë të pjesshme të Komisionit Shtetëror të Ndihmës Juridike përfitojnë një shpërblim, në masën 5 000 (pesë mijë) lekë për çdo mbledhje, por jo më shumë se 10 000 (dhjetë mijë) lekë në muaj.”.

2. Punonjësit mbështetës të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve, Agjencisë Kombëtare të Provimeve, Organit kombëtar të Investigimit të Aksidenteve/Incidenteve ajrore në Aviacionin Civil, Teatrit Kombëtar të Komedisë, Komisionit Shtetëror të Ndihmës Juridike dhe Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, të paguhet sipas vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave, për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve

buxhetore.

3. Efektet financiare për zbatimin e këtij vendimi, për vitin 2011, të përballohen nga fondet e këtyre institucioneve, të miratuara për vitin 2011.

4. Ky vendim i shtrin efektet financiare:

- Për Agjencinë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve, Agjencinë Kombëtare të Provimeve, Organin Kombëtar të Investigimit të Aksidenteve/Incidenteve Ajrore në Aviacionin Civil, Teatrin Kombëtar të Komedisë, Komisionin Shtetëror të Ndhmës Juridike, nga data e emërimit të nëpunësve/punonjësve në detyrë.

- Për Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

5. Vendimi nr.1106, datë 30.7.2008 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës së pagës së punonjësve të Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha